

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi kryetar, Dr.sc.Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.H. për shkak të veprës penale Kontrabandim me migrant nga neni 170 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe krim i organizuar nga neni 283 par.1 të KPRK-së dhe J.J. nga fsh... K.Gjilanit, për shkak të veprës penale Kontrabandim me emigrant nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së dhe Krim i organizuar nga neni 283 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të R. të Kosovës dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit J.J. av. Y.H., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.58/16 të datës 22.01.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me 04.04.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Speciale të R. të Kosovës dhe ajo e mbrojtësit të akuzuarit J.J., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.58/16 të datës 22.01.2019, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan me aktgjykimin, PKR.nr.58/16 të datës 22.01.2019, e ka shpallur fajtor të akuzuarin J.J. për shkak të veprës penale Kontrabandim me emigrant nga neni 170 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) euro të cilin dënim me burgim do ta mbaje përkatësisht me gjobë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit në të kundërtën dënimi i caktuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgu duke i llogaritur nga 20 euro për një ditë burgimi. Në dënimin e shqiptuar me burgim të akuzuarit do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 18.03.2014 deri me 17.11.2014. të dëmtuarit L.H., M.H., V.A., L.U. dhe R.A. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil. Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësorë në shumën prej 50 euro si dhe shpenzimet tjera sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe 50 euro për kompensimin e viktimave të krimit. Konform nenit 363 par.1 pika

1.1 të KPRK-së ndaj të akuzuarit B.H. refuzohet akuza. Shpenzimet e procedurës bien barrë e mjeteve buxhetore të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

-Prokurori i Prokurorisë Speciale të R. të Kosovës për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe ta ndryshoj aktgjykimin sa i përket sanksionit penal ashtu që të akuzuarit J.J. ti shqiptoj dënim më të lartë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit J.J. av. Y.H. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa, aktgjykimi ankimuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo duke e ndryshuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezent ishte i akuzuari J.J., mbrojtësi i tij av.Y.H., ndërsa munguan Prokurori i Apelit, të dëmtuarit L. dhe M.H., V.A., L.U. dhe R.A. edhe pse të ftuar me rregull. Mbrojtësi av.Y.H. mbeti pranë propozimit me shkrim të ankesës, ndërsa i akuzuari mbështeti fjalët e mbrojtësit të tij.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.102/19 të dt. 11.03.2019 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të R. të Kosovës të ndryshohet aktgjykimi dhe të akuzuarit J.J. ti shqiptohet dënim më i lartë. Kurse të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.J. av. Y.H..

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat janë të pa bazuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.J. av. Y.H. në ankesë konsideron se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që me këtë aktgjykim është shkelur ligji në dëm të akuzuarit, sikur që vendimi mbi sanksionin penal është shumë i ashpër dhe i lartë. Sipas mbrojtësit vet dispozitivi nën I i aktgjykimin të ankimuar ka kundërthënë të atilla nga të cilat mund të nxirret një përfundim që në veprimet e të akuzuarit është vërtetuar figura e veprës penal, për të cilën ky i akuzuar është shpallur fajtorë dhe është gjykuar.

Nga shkresat e lëndës e sidomos nga transkripta telefonike vërtetohet se personi me emrin P.N. Është ai i cili ka siguruar dokumentacionin e të dëmtuarve për kalimin e kufirit Maqedoni- Greqi dhe pikërisht ky bashkëpunim i të akuzuarit J. me P. N. Përbejnë figurën e veprës penale nga par.2 i nenit 170 të KPRK-së për çka me të drejtë konstatojmë se aktgjykimi i ankimuar përveç shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale më këtë është shkelur edhe ligji penal. Nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë mbrojtja konsideron se vendimi mbi dënim është shumë i lartë dhe i ashpër.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit J.J., si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale por as shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare është e obliguar ti shqyrtojë. Kjo për faktin se pretendimi i mbrojtjes kryekëput ka të bëjë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për të cilën mbrojtësi nuk ka pasur të drejtë ta atakoj pasi i akuzuari ka pranuar fajësinë në prani të mbrojtësit të tij dhe gjykata bazuar në dispozitat ligjore për pranim fajësie ka aprovuar të njëjtën dhe ka shpallur aktgjykimin si në dispozitiv të saj. Pavarësisht kësaj gjykata vlerësoj pretendimet e mbrojtjes dhe konstaton se nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se aktgjykimi pavarësisht pranimit të fajësisë është bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe se është vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Meqë aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe mbrojtjes nuk janë të bazuara. Në ankesat e tyre nuk theksohen fakte dhe rrethana të reja e të cilat nuk i ka pasur Gjykata e shkallës së parë por Prokuroria thekson se dënimi është shumë i butë në krahasim me peshën e përgjegjësisë penale të kryesit dhe mënyrën e kryerjes se veprës ndërsa mbrojtja shton se rrethanat lehtësuese nuk janë vlerësuar drejtë ndërsa përveç përshkrimit të rrethanave renduese gjykata nuk ka dhënë arsye se cilat nga këto rrethana renduese kanë ndikuar që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim kaq i rëndë. Mirëpo duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese të vlerësuara drejtë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë edhe atë: si rrethanë lehtësuese se i akuzuari e ka pranuar fajësinë duke shprehur keqardhje të thellë, kërkim falja të dëmtuarve, sjellja e mirë e tij në gjykatë, se është mbajtës i familjes dhe i gjendjes së varfër ekonomike ndërsa në anën tjetër si rrethana renduese shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit dhe rrezikshmëria shoqërore e veprës penale bazuar në mënyrën e kryerjes se, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.97/2019, më 04.04.2019

Procesmbajtëse,
Leonita Lajçi

Kryetar i kolegjit- gjyqtari
1. Xhevdet Abazi_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala _____